



JAVA E GRUAS 2020

Java e Gruas (WoW) është një ngjarje vjetore mbarëkombëtare që mbledh në një mjedis ndër-etnik, më shumë se 120 gra dhe burra nga partitë politike, shoqëria civile, biznesi, media dhe akademia, me qëllim të zgjerimit dhe forcimit të kapaciteteve të grave udhëheqëse dhe ti mbështesë ato për të marrë pozicione më të mëdha drejtuese. Gjatë tetë viteve të fundit, WoW ka ofruar një platformë për debat mbi politika dhe diskutim intensiv me politikanë prominent dhe zyrtarë të zgjedhur. Kjo u mundëson pjesëmarrësve të mbajnë në përgjegjësi përfaqësuesit e tyre përderisa në të njejtën kohë mbështesin zhvillimin e shkathtësive të lidershit për gratë në politikë.

WoW organizohet nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI) në Kosovë, me mbështetjen bujare të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). NDI gjithashtu dëshiron të falënderojë Ambasadën e Kanadasë në Kroaci dhe Kosovë dhe UN Women për mbështetjen e Javës së Gruas 2020. Si një organizatë jopartiake që mbledh panelist dhe pjesëmarrës nga i gjithë spektri politik, NDI me mirësi kërkon që panelistët të përmbahen nga deklaratat partiake. Të gjitha diskutimet do të regjistrohen dhe transmetohen drejtpërdrejt.

Konferenca e fillimit të Javës së Gruas

Ta ndryshojmë fytyrën e politikës: Koha është tani!
Me ritmin aktual do të duhen 95 vite për arritjen e barazisë gjinore.
Demokracia nuk mund të presë aq gjatë.

Prishtinë, Kosovë
15-16 dhjetor, 2020

*Keni parasysh që të gjitha kohët e listuara janë sipas kohës lokale
(GMT +1, apo EST - 6)*

*Moderatore kryesore e Javës së Gruas 2020: Fitore Rexhepi,
Gazetare në RTK*

E martë, 15 dhjetor

13:10 Fjalët hyrëse

- Ambasadori Derek Mitchell, President i Institutit Kombëtar Demokratik
- Kelley Currie, Ambasadore e Përgjithshme e SHBA për Çështjet Globale të Grave

13:30 - 13:55 Politika në Epokën e Digjitalizimit: Mundësitë dhe Sfidat për Gratë

Pjesëmarrja e grave në politikë në kushte të barabarta me burrat është qenësore për demokracinë. Panelistët do të diskutojnë për barazinë gjinore në kontekstin e “politikës digjitale” të mediave sociale, në veçanti gjatë pandemisë së shkaktuar nga COVID-19 dhe mënyrën se si gratë mund të përfitojnë nga shtrirja në media sociale duke lundruar nëpër kërcënimet me bazë gjinore.

- Vjosa Osmani, u.d Presidente dhe Kryetare e Kuvendit të Kosovës
- Philip S. Kosnett, Ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë

Moderatore: Fitore Rexhepi, Gazetare në RTK

14:00 - 14:45 Kuvendi i bashkuar në diversitet

Kuvendi i Kosovës bashkon anëtarë me elektorate të ndryshme politike dhe përkatësi të ndryshme etnike të debatojnë dhe miratojnë ligje të cilat kanë ndikim në jetën e qytetarëve. Panelistët do të diskutojnë për rolin udhëheqës të Kuvendit që formësohet nga faktorët institucional, politik, dhe shoqëror dhe se çfarë mund të bëjë Kuvendi në avansimin e rolit të tij në shoqërinë Kosovare, veçanërisht nga këndvështrimi i barazisë gjinore.

- Arbërie Nagavci, Nënkyetare e Kuvendit të Kosovës
- Vlora Limani Hajnuni, Deputete dhe Kryesuese e Grupit të Grave Deputete në Kuvendin e Kosovës
- Veton Berisha, Deputet në Kuvendin e Kosovës

Moderatore: Jovana Radosavljevic, Drejtore e Iniciativa e Re Sociale

15:00 - 15:45 Krizat globale: Ndikimi i tyre në barazinë gjinore

Gjatë pandemisë demokracia është duke u testuar në gjithë botën ku krerët autoritarë të shtetit imponojnë kufizime në funksionimin demokratik të vendit dhe vënë cenime në lirinë e shprehjes dhe të drejtave themelore të njeriut, duke përfshirë të drejtat e grave dhe vajzave. Panelistët do të diskutojnë ngritjen e grave në të gjithë botën për të drejta demokratike dhe si mund të sigurojnë që të drejtat e tyre janë të mbrojtura.

- Madeleine K. Albright, Sekretare e Shtetit në SHBA (1997 - 2001) dhe Kryesuese e Bordit të NDI
- Atifete Jahjaga, Presidente e Republikës së Kosovës (2011 - 2016)

Moderatore: Fitore Rexhepi, Gazetare në RTK

16:00 - 17:15 Legjislacioni i ndjeshëm gjinor: Në kërkim të mundësive të barabarta

Në bazë të parimit të barazisë të drejtat e njeriut nuk mund të realizohen pa garantuar të drejta të barabarta mes burrave dhe grave. Panelistët do të diskutojnë mënyrën si parlamentet nxjerrin ligje me konsideratë ndaj barazisë gjinore dhe nga këndvështirmi i krijimit dhe qëndrueshmërisë së politikave publike me përmbajtje të barazisë gjinore.

- Shkëmb Manaj, Deputet në Kuvendin e Kosovës
- Mimoza Kusari Lila, Deputete në Kuvendin e Kosovës
- Ariana Musliu Shoshi, Deputete në Kuvendin e Kosovës
- Christine Todd Whitman, Guvernatore e 50-të e New Jersey, SHBA
- Lois Frankel, Përfaqësuese në Kongres, SHBA
- Lukas Mandl, Deputet në Parlamentin Evropian

Moderator: Arben Loshi, Drejtor i Drejtorisë për Hulumtim, Bibliotekë dhe Arkiv, Kuvendi i Kosovës

17:30 - 18:15 Përrshpejtimi i ndryshimit: Gratë në paqe dhe siguri

Instrumentet dhe mekanizmat ndërkombëtar për barazi gjinore duke përfshirë Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1325 mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë, vetëpërmbyajnë përfshirjen formale të grave në margjinat e strukturave të ndërtimit të paqes dhe zgjidhjes së konflikteve. Ky panel do të fokusohet në progresin e arritur dhe mangësitë në zbatimin e kësaj rezolute dhe instrumenteve të ngjashme ndërkombëtare.

- Samantha Power, Ambasadore e SHBA në Kombet e Bashkuara (2013 - 2017)

Moderatore: Nita Luci, Antropologe, Universiteti i Prishtinës

18:15-18:25 Fjalët përmbyllëse

- Michelle Bekkering, Ndhimës Administratore, Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar e SHBA (USAID)

18:30 Përmbyllja

E mërkurë, 16 dhjetor

13:00 - 13:10 - Fjalët hyrëse

- Alia El-Yassir, Drejtore Rajonale për Evropë dhe Azi Qendrore në UN Women

13:10 - 13:55 Tejkalimi i ndikimit socio-ekonomik i shkaktuar nga pandemia Covid-19

Covid-19 ka vënë në testim kohesionin shoqëror të Kosovës, stabilitetin politik, mirëqenien ekonomike dhe shëndetin individual, me gratë duke marrë përsipër barrë joproporcionale. Si po siguron Qeveria e Kosovës vendimmarrjen gjithëpërfshirëse dhe zhvillimin e politikave në menaxhimin e goditjeve pandemike në kohë reale dhe njëkohësisht përfshirjen e grave në tryezë në përcaktimet për rimëkëmbje.

- Avdullah Hoti, Kryeministër i Kosovës

Moderatore: Jeta Krasniqi, Menaxhere e Projektit në KDI

14:00 - 14:50 Zgjedhjet Lokale 2021 në Kosovë: rrugë për sukses më të madh për gratë

Demokracia dhe zgjedhjet gjithëpërfshirëse janë pikënisja për qeverisje demokratike dhe gjithëpërfshirëse. Panelistët do të fokusohen në rolin që luajnë partitë politike në fushata zgjedhore duke mbështetur gratë kandidate deri tek përmbajtja e platformave gjinore, reduktimi i barrierave në udhëheqjen politike të grave, dhe si mund të arrihet kjo gjatë krizave të shëndetit publik.

- Teuta Haxhiu, Nënkyetare e AAK
- Uran Ismaili, Sekretar i Përgjithshëm i PDK
- Emiliya Redzeqi, Kryetare e NDS

Moderator: Albert Krasniqi, Drejtor i programit në Demokraci plus

**15:00 – 16:15 Ruajtja e paqes dhe stabilitetit:
perspektiva gjinore në proceset e zgjidhjes së konflikteve**

Studimet tregojnë që në rastet kur gratë janë të përfshira në struktura formale të ndërtimit të paqes, shfaqen zgjidhje më të mira dhe më të qëndrueshme. Ky diskutim do të sjellë një perspektivë ndërkombëtare dhe për sfidat e Kosovës në proceset e pajtimit dhe ndërtimit të paqes.

- Meliza Haradinaj, Ministër i Punëve të Jashtme dhe Diasporës në Kosovë
- Ann Linde, Ministre e Punëve të Jashtme në Suedi
- Rob Oliphant, Deputet / Sekretar në Parlament për Ministrin e Punëve të Jashtme, Kanadë

Moderator: Leon Malazogu

16:30-17:15 Ngjitja e “shkëmbit të qelqtë” nga gratë dhe të rinjtë

Numri rekord i grave të zgjedhura në Kuvendin e Kosovës përtej kuotës së vendosur dhe ngritja e numrit të deputetëve të rinjë në moshë dëshmon përpjekjet për ndryshim të pamjes së lidërshipt politik të Kosovës. Ky sesion do të fokusohet në veprimet e partive politike për mbështetjen e grave dhe të rinjëve në ngjitjen e shkallëve të suksesit.

- Albin Kurti, Kryetar i LVV

Moderatore: Fitore Rexhepi, Gazetare në RTK

17:20-17:40 Reflektimi për gratë e Kosovës: Çfarë është arritur

- Edita Tahiri, Zv. Kryeministër dhe Kryenegociatore e mëparshme e Kosovës

Moderatore: Fitore Rexhepi

17:40-18:00 Komentet përfundimtare dhe përmbyllja

- Alan Bowman, Ambasador i Kanadasë në Kroaci dhe Kosovë
- Ambasadore Nancy Soderberg, Drejtore e NDI në Kosovë



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Canada

